

Indeksi i Çmimeve të Importit

Tremujori I, 2016


Tiranë, më 06 Qershor: Në tremujorin e parë të vitit 2016, Indeksi i Çmimeve të Importit arriti 96,3 % kundrejt vitit 2012. (Viti 2012 = 100).

Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Importit është -2,8 %. Indeksi i Çmimeve të Importit në aktivitetet e Industrisë përpunuese ka shënuar ulje me 2,6 %. Vihet re ulje e çmimeve të importit të produkteve në aktivitetin “Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara” me 18,1 %, “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” me 10,4 %, dhe “Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës” me 9,8 %.

Në tremujorin e parë 2016 ndryshimi tremujor i indeksit është -0,6 %. Çmimet e Importit në seksionin “Industria Përpunuese” shënuan ulje me 0,5 % krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Në këtë seksion vlen të përmendet ulja e çmimeve të produkteve në aktivitetin e “Përpunimi i tekstileve” me 2,7 % dhe “Prodhimi i mjeteve të transportit ” me 2,1 %. Ndërsa çmimet e importit të produkteve në aktivitetet: “Konfeksionimi i veshjeve” shënoi rritje me 2,8 % dhe “Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit” shënoi rritje me 2,4%.

Indeksi i Çmimeve të Importit të seksionit “Industria nxjerrëse” kanë pësuar rritje me 3,6 %, ku rritjen më të madhe shënon aktiviteti “Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve ” me 6,5 %.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit sipas muajve , Janar 2015 – Mars 2016



Për publikim 06/06/2016

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Importit

2012=100

%

NVE	Përshkrimi	Peshat	01 - 16	02 - 16	03 - 16	I - 16
	Gjithsej	100,0	96,3	96,1	96,6	96,3
B	Industri Nxjerrëse	0,4	101,6	101,4	96,6	99,9
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,2	109,3	109,3	98,5	105,7
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	93,9	93,7	93,6	93,7
C	Industria Përpunuese	95,5	97,1	96,8	97,5	97,1
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,9	94,6	94,9	94,6	94,7
11	Prodhimi i pijeve	2,0	96,5	96,5	96,5	96,5
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	101,3	101,3	101,3	101,3
13	Përpunimi i tekstileve	5,5	105,7	105,2	105,5	105,5
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,6	107,1	106,9	106,7	106,9
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,2	89,7	88,4	89,3	89,1
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	102,4	102,4	102,6	102,5
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrë	3,0	94,4	93,8	93,4	93,9
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,1	80,2	80,2	80,2	80,2
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,4	88,5	86,9	92,7	89,4
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,7	96,1	96,4	96,9	96,4
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	3,8	103,9	103,9	103,9	103,9
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	95,4	96,0	95,7	95,7
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,2	95,7	95,5	95,6	95,6
24	Metalurgjia	5,2	92,7	92,4	91,8	92,3
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,5	104,2	103,8	103,7	103,9
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,0	98,6	98,6	99,3	98,8
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	5,3	100,9	100,8	100,8	100,8
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	6,9	105,4	105,5	105,7	105,5
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	3,4	107,2	107,2	107,2	107,2
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,6	88,5	88,5	88,5	88,5
31	Prodhimi i mobiljeve	0,7	98,7	98,7	98,7	98,7
32	Industri të tjera p,k,t	1,6	96,4	96,9	96,9	96,7
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	2,8	83,8	91,2	85,2	86,7
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	2,8	83,8	91,2	85,2	86,7
E	Furnizimi me ujë, aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,3	89,7	78,4	80,1	82,7
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	89,7	78,4	80,1	82,7

Tab. 2 Ndryshimet tremujore dhe vjetore të Indeksit të Çmimeve të Importit

			%	
NVE	Përshkrimi	Peshat	I-16 / I-15	I-16 / I-15
	Gjithsej	100,0	-0,6	-2,8
B	Industri Nxjerrëse	0,4	3,6	-2,8
05	Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve	0,2	6,5	-1,3
08	Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat apo karrierat	0,2	-0,2	-4,5
C	Industria Përpunuese	95,6	-0,5	-2,6
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,9	0,8	0,2
11	Prodhimi i pijeve	2,0	-0,5	-5,7
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	1,3	-0,1	1,4
13	Përpunimi i tekstileve	5,5	-2,7	-1,7
14	Konfeksionimi i veshjeve	5,6	2,8	1,5
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	5,2	-1,9	0,0
16	Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri dhe dushku, përveç mobiljeve; prodhimin e artikujve prej kashte dhe xunkthi	1,4	-0,6	-1,7
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrë	3,0	-0,9	-0,8
18	Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara	0,1	0,0	-18,1
19	Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës	8,4	-0,3	-9,8
20	Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike	7,7	-1,6	-2,5
21	Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë	3,8	-1,0	-0,5
22	Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës	4,0	-0,9	0,2
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,2	0,2	-0,6
24	Metalurgjia	5,2	-1,4	-7,3
25	Prodhimi i produkteve metalikë të fabrikuar, përveç makinerive dhe pajisjeve	4,5	-0,3	-0,2
26	Prodhimi i produkteve optikë, elektronikë, kompjuterikë	5,0	-0,7	-5,2
27	Prodhimi i paisjeve elektrike	5,3	0,2	0,5
28	Prodhimi i makinerive dhe paisjeve p,k,t	6,9	-0,1	2,1
29	Prodhimi i mjeteve të transportit, rimorkiove dhe gjysëmrimorkiove	3,4	-2,1	-3,3
30	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	0,6	2,4	-10,4
31	Prodhimi i mobiljeve	0,7	-0,6	2,6
32	Industri të tjera p,k,t	1,6	-1,7	-2,8
D	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	2,8	-0,6	-3,2
35	Energjia elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	2,8	-0,6	-3,2
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	1,3	-9,1	-13,5
38	Aktivitetet e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve; rikuperimi i materialeve	1,3	-9,1	-13,5

Metodologjia

INSTAT për herë të parë llogarit dhe publikon Indeksin e Çmimeve të Importit i cili mat ecurinë e çmimeve të transaksioneve të produkteve industriale të importuara për tu shitur në tregun Vendas. Indeksi i Çmimeve të Importit është tregues statistikor i cili është pjesë e Programit të Statistikave Zyrtare 2012 – 2016 dhe llogaritja, metodologjia e përdorur mbështeten në Rregulloren e Këshillit Evropian Nr. 1165/98 e datës 19 maj 1998, amenduar nga rregullorja e KE-së Nr. 1158/2005 të datës 6 korrik 2005 për Statistikat Afatshkurtra.

Klasifikimi. Klasifikimi i përdorur është Klasifikimi statistikor i Aktiviteteve ekonomike NVE Rev.2. Çmimet e importit mblidhen, përpunohen dhe publikohen në bazë të Klasifikimit të Produkteve sipas Aktivitetit Ekonomik (CPA 2008). Produktet janë klasifikuar në nivel 6 shifror sipas NP 2008 (CPA2008) në aktivitetin në të cilin ato janë importuar.

Njësia e vërtimit. Si njësi e vërtimit për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Importit janë ndërmarrjet ekonomike të cilat importojnë produkte nga tregu i huaj. Vërtimi përfshin të gjitha ndërmarrjet të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në aktivitetin e prodhimit ose tregtisë dhe mbulojnë 80% të vlerës së importeve në aktivitetin ku bëjnë pjesë.

Kryerja e Vërtimit për Çmimet e Importit ka filluar në vitin 2012. Ky vit është dhe periudha referuese e Indeksit të Çmimeve të Importit (IÇI). Të dhënat e llogaritura janë në seri kohore 2012 – Tr.1.2016.

Projekti për llogaritjen e Indeksit të Çmimeve të Importit ka filluar në vitin 2011 nën asistencën e ekspertëve të SIDA-s. Të gjitha etapat e punës ku përfshihen: korniza konceptuale, dizenjimi i pyetësorit, metodologjia, aplikacioni i hedhjes, përpunimit dhe llogaritjes së të dhënave dhe publikimi është e ngjashëm me ato të Indeksit të Çmimeve të Prodhimit. Lista e produkteve përfaqësuese dhe e ndërmarrjeve respektive zgjidhet bazuar në të dhënat e importit nga autoritetet doganore. Të dhënat përpunohen dhe llogariten në SQL.

Në vitin 2016 u anketuan 620 ndërmarrje të cilat raportojnë 1054 çmime produktesh të importuara. Përpjekja e parë për zgjedhjen e produkteve dhe ndërmarrjeve është bërë në bazë të të dhënave të importit për vitin 2010 dhe 2011, duke zgjedhur ndërmarrjet të cilat jo vetëm ishin përfaqësuese në grup produktet e zgjedhura por dhe reflektonin stabilitet në segmentet e tregut ku ato operonin. Fillimisht u zgjidhën 300 ndërmarrje të cilat u anketuan në TR 1 2012.

Mbledhja e të dhënave. Të dhënat grumbullohen me vërtim tremujor dhe informacioni mbi çmimet e transaksioneve është mujor. Vërtimi realizohet me intervistim të drejtpërdrejtë. Në pyetësorë janë vetëm produktet më përfaqësuese për ndërmarrjen të cilët kanë një kod gjashtë-shifror sipas NP 2008, përshkrimin e produktit, njësinë matëse, vendin e origjinës.

Llogaritja e indeksit. Indeksi i ri i Çmimeve të Importit është indeks zinxhir (me periudhë bazë vitin 2012 = 100). Sipas kësaj metode çmimi i çdo produkti në periudhën korrente (y) krahasohet me çmimin që ai ka patur në muajin Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1). Treguesi i llogaritur është çmimi relativ i produktit. Çmimet

relative peshohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 6 shifror për çdo grup produkti. Indekset e llogaritura në nivel 6 shifror agregohen së bashku për të dhënë indeksin në nivel 2 shifror dhe kështu me rradhë deri në llogaritjen përfundimtare të indeksit.

Çmimi relativ. Çmimi relativ është raporti i çmimit të produktit në periudhën korente me çmimin e produktit në dhjetor të vitit të mëparshëm.

Peshimi. Mesatarja e peshuar aritmetike e indekseve elementare të produkteve individuale do të formojë indeksin. Indeksi në (short - term - link) për nivelin 6 shifror sipas NVE Rev.2 është llogaritur duke shumëzuar çdo peshë të produktit në nivel 6 shifror me çmimin relativ korespondues dhe duke pjesëtuar shumën e tyre me shumën e peshave.

Imputimi. Imputimet bëhen duke shumëzuar çmimin e periudhës së mëparshme me ndryshimin mesatar të çmimeve të produkteve të grupit në të cilin bën pjesë produkti (në nivelin më të ulët të agregimit 6 ose 2 shifror).

Formula e llogaritjes. Për llogaritjen e indeksit është përdorur formula e tipit Laspeyres zinxhir:

$$I_0^t = \frac{\sum_k P_{t;k} Q_{0;k}}{\sum_k P_{0;k} Q_{0;k}} = \sum_k \frac{P_{0;k} Q_{0;k}}{\sum_k P_{0;k} Q_{0;k}} \times \frac{P_{t;k}}{P_{0;k}}$$

ku:

$I_{(t)}$ - indeksi i periudhës t krahasuar me bazën 0 ;

P_{it} - çmimi i artikullit i në periudhën t;

P_{i0} - çmimi i artikullit i në periudhën 0 ;

Q_{i0} - sasia e artikullit i në periudhën 0.

Ky version i formulës së Laspeyres mund të rishkruhet si :

$$I(t) = \sum [W(i) * LTR(i, t-1, 0) * STR(i, t, t-1)]$$

Ku:

LTR (i, t-1, 0) është çmimi relativ ndërmejt periudhës t-1 dhe periudhës 0 dhe

STR (i, t, t-1) është çmimi relativ ndërmejt çmimit të periudhës korente t dhe çmimit të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar.

Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.